

# **A K T T H E M E L I M I**

## **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“Dynamic Software Development” SHPK**

**Datë 20/09/2020**

#### **ORTAKEU I VETEM I SHOQERISE**

**Z.Ardit Çaushllari**, i biri i Behar-it, lindur Gjerbës, Skrapar me 20.09.1990, Rruga Nexho Konomi, Kompleksi rezidencial “Green City”, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftimin me numer 033385716, me datë leshimi 19.05.2017, dhe ID nr. J00920089L, madhor dhe me zotesi te plote juridike për te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 “Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit” dhe ne Legjislacionin shqiptar ne përgjithësi, personat e mesiperm, jane Ortaket e Shoqerise si me poshte”.

#### **Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise**

##### **Neni 1**

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

##### **Neni 2**

Shoqeria eshte emertuar **“DYNAMIC SOFTWARE DEVELOPMENT” shpk, shkurt DSD.**

##### **Neni 3**

Shoqeria ka Selin e saj ne : Lagjja nr. 2, Rruga Sefer Efendiu, Pallati Karanxha, Kati i dyte, Zona Kadastrale 8512, Durres, Shqipëri.

##### **Neni 4**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Shoqeria **“DYNAMIC SOFTWARE DEVELOPMENT” shpk** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

##### **Neni 5**

Shoqeria **“DYNAMIC SOFTWARE DEVELOPMENT” shpk** zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Dizenjim software-i

Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software

Testim software

Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit  
Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë  
Zhvillim sistemesh migrimi  
Përmirësim/upgrade sistemesh informatike  
Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.

#### **Neni 6**

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri dhe jashtë saj.

#### **Neni 7**

Selia e shoqërise mund të transferohet.

#### **Neni 8**

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave e përfitojnë Ortaku i Shoqërise.

Ortaku themelues perballon humbjet e shoqërise deri në kufirin e vlerës së derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të rritet nga fitimi, në natyrë, ose kredi në leke ose valute që merret në Banke si dhe me kapitale të derdhura nga vetë ortaku.

Kapitali i Shoqërise është në shumën 100,000 (njqind mijë) Lek, i përbërë nga 1 (një) kuote, me vlerë 100,000 (njqind mijë) Lek. Ortaku ka një kuote kapitali si më poshtë:

$$\text{Ardit Çauhillari} = 1 \text{ Kuote} = 100\% = 100,000 \text{ Lek}$$

Fitimet që do të rezultojnë pas miratimit të bilancit vjetor nga Ortaku i Vetem pas zbritjes së taksave do të ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi që i takon Ortakut Themelues.

#### **Neni 9**

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërise.

#### **Neni 10**

Veprimtaria e shoqërise mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me ligjin shqiptar ose të huaj.

#### **Administrimi**

**Organi vendimor i shoqërise është Ortaku i Vetem.**

#### **Neni 11**

##### **ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET**

Në shoqërinë “DYNAMIC SOFTWARE DEVELOPMENT” shpk, administratori i shoqërise do të jetë:

**Z.Ardit Çauhillari**, i biri i Behar-it, lindur Gjerbës, Skrapar më 20.09.1990, Rruga Nexho Konomi, Kompleksi rezidencial “Green City”, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër 033385716, më datë leshimi

19.05.2017, dhe ID nr. J00920089L, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratori emerohet per nje afat kohor prej 5 vjetesh. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem.

**Mbyllja e Shoqerise:**

**Neni 12**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Ortaku i Vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

**Kur shoqeria likujdohet:**

**Neni 13**

Ortaku i Vetem emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

**Neni 14**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku i Vetem. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve. Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

**ORTAKU I VETEM**

**“DYNAMIC SOFTWARE DEVELOPMENT” shpk**

**Ardit Çaushllari**

Ardit Çaushllari  
